



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.134, datë 07.06.2023

PËR

“CAKTIMIN E ZOTIT ARIAN MUÇA NË DETYRËN E PROKURORIT NË  
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET  
PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e zotit Arian Muça në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin vakant Nr.7, shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.67, datë 21.03.2023.
2. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Arian Muçaj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datë 19.06.2023 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 07.06.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Nurihan Seiti



ANËTAR  
Elaida Coxhi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Arta Mandro

ANËTAR  
Ledina Riza

